



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 23.08.2012, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Sami Hamiti, Mustafë Krasniqi, Tefik Mehmeti, Hazir Borovci, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Shemsi Veseli dhe Shefqet Sylejmani.

Mungoi Engin Beyoglu.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive të Komunës dhe përfaqësuesit e OSBE - së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Sami Hamiti, kryesues.

Njëzëri u miratua ky

REND DITE :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së shtatë;
2. Propozimvendimi për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës;
3. Propozimvendimi për miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave për raste sociale;
4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme;
5. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit të investimeve kapitale për vitin 2012;
6. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Ndërmarrjes Publike Banesore në lagjen “Pejton”;
7. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për dhënien e parcelës kadastrore në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë – Menaxhmentit për Elektronikë, Logjistikë dhe Pronë (HM EL Zrt) për ndërtimin e Qendrës Rekreative – Sportive 01. nr. 46-1064, dt. 5.06.2009 ;
8. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për ndërrimin e paluajtshmërisë – tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Prishtinës;
9. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale, 01 nr. 110 – 2782, të dt. 02.12.2011;
10. Propozimvendimi për emërimin e Këshillit të ekspertëve për planifikim;
11. Të ndryshme.

Faqe 1 nga 6

Pika e parë

Njzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së shtatë.

Pika e dytë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **kryesuesi**.

Shemsi Veseli tha se lidhur me këtë kemi rënë dakord edhe me kryetarin, andaj do të ishte mirë që zyrtari i Zyrës ligjore të bëjë intervenim në Rregulloren për ndarjen e banesave, duke ia shtuar edhe një nen, me të cilin do të rregullohej çështja e meritokracisë, në mënyrë që dikush të mos e humb kontestin në gjyq.

Aziz Pacolli propozoi që gjatë vendosjes së përfituesve nëpër banesa të kontrollohen se a janë personat e njëjtë, pasi që ka shumë keqpërdorime në këtë drejtim.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

U konstatua se njzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e listës përfundimtare për dhënien e banesave me qira familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tretë

U konstatua se njzëri u përkrah Propozimvendimi për miratimin e listës përfundimtare për dhënien e banesave me qira për raste sociale dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e katërt

Përkritazi me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Kryesuesi tha se është bërë harmonizimi dhe rishikimi i kësaj rregulloreje, gjithnjë duke pasur parasysh që të mos ngarkohet qytetari.

Shemsi Veseli shtoi se kemi obligim që ky harmonizim të bëhet, në mënyrë që qytetari të hyjë në sistem për pagimin e tatimit në pronën e tij të paluajtshme.

U konstatua se njzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e pestë

Arsyetimin për këtë pikë të rendit të ditës e paraqiti **Xhelil Bekteshi**.

Shefqet Sylejmani shfaqi dilemën se a do të thotë kjo që po hiqet dorë nga disa projekte nga ana jonë, apo nga ana e nivelit qendror, si te rreth-rrotullimi në rrugën për në Gjilan, apo është heqje dorë për rrugën që qon në Shkup. Lidhur me NP “Termokos”, pyeti se a po zvogëlohet kogjenerimi, apo po bëhet shtyrja e afatit, dhe cilat janë pasojat e këtyre ndryshimeve. Ai shprehu mendimin se do të ishte mirë që këto mjete të shkojnë në favor të gjelbërimit, terreneve sportive etj.

Tefik Mehmeti shtroi pyetjen se a mund të shpenzohen mjetet në pjesën ku janë paraparë projekte, pasi që është afati i shkurtër, vetëm prej dy muajsh, për shpenzimin e tyre.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë dhe u përgjigj në pyetjet e parashtruara.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e buxhetit të investimeve kapitale për vitin 2012 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e gjashtë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Shefqet Sylejmani pyeti se ku gjendet lokacioni i propozuar për këtë çështje.

Kryesuesi u përgjigj në pyetjen e parashtruar.

U konstatua se u përkrah Propozimvendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për Ndërmarrjen Publike Banesore në lagjen “Pejton” dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e shtatë

Përkritazi me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

Shemsi Veseli u pajtua me këtë propozim, por sugjeroi që në vend të 18 muajve për fillimin e punimeve, të jetë 36 muaj.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për dhënien e parcelës kadastrore në shfrytëzim Ministrisë së Mbrojtjes së Hungarisë–Menaxhmentit për Elektronikë, Logjistikë dhe Pronë (HM EL Zrt) për ndërtimin e Qendrës Rekreative – Sportive, 01 nr. 46-1064, dt 5.06.2009, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e tetë

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Shemsi Veseli u shpreh se është për atë që të përmirësohet gabimi, por nëse ai përsëritet, atëherë është i qëllimshëm.

Kryesuesi paraqiti sqarime shtesë.

Tefik Mehmeti tha se këto gabime bëhen nga mangësitë, kur skicat vinë të pa qatra, andaj kërkoj që gjërat të na sqarohen deri në detaje, andaj skica dhe sqarime duhet pasur më shumë.

U konstatua se u përkrah Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për ndërrimin e paluajtshmërisë – tokës ndërtimore në pronësi të Komunës së Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e nëntë

Arsyetimin për këtë propozim e paraqiti **Agim Salihu**.

Shemsi Veseli propozoi që të shtohet edhe një nen, që do të parashihte se Kuvendi duhet të informohet për çdo vendim që merr Kryetari me Këshillin e Drejtorëve.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, 01 nr. 110-2782 , të dt. 02.12.2011 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e dhjetë

Përkitazi me këtë pikë të rendit të ditës informoi **Agim Salihu**.

Aziz Pacolli propozoi që përveç emrave dhe profesionit të kandidatëve, këtij propozimi t'i shtohet edhe një biografi e shkurtër e secilit nga të propozuarit.

Kryesuesi informoi shkurtimisht për secilin nga kandidatët e propozuar.

Shemsi Veseli uroi që ky këshill i ekspertëve të punojë si duhet dhe të përfillen mendimet e tyre profesionale. Është mirë që të definohen gjërat, në mënyrë që të mos interferohen disa çështje që nuk duhen dhe të thuhet se prej nga ky grup do të paguhet dhe sa do të jetë çmimi i pagës së tyre, si dhe të definohet roli i këtyre këshilltarëve.

Kryesuesi paraqiti disa sqarime shtesë.

Shemsi Verseli u shpreh se jemi të gjithë të vetëdijshtëm pse nuk po funksionojnë komitetet. Është mirë që së paku të kryhet ana formale.

Shefqet Sylejmani mbështeti kërkesën dhe shqetësimet e paraqitur nga Aziz Pacolli dhe u pajtua me vërejtjet e dhëna nga Shemsi Veseli, për këtë pikë dhe për ato paraprake.

U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për emërimin e Këshillit të ekspertëve për planifikim dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pika e njëmbëdhjetë

Të ndryshme

Aziz Pacolli tha se në Pallatin e Rinisë ka filluar rrënimi i objekteve hoteliere, edhe pse ato objekte nuk pengonin. Nëse kanë kontratë, atëherë pse ndodh një gjë e tillë, mos ndoshta ka të bëjë me rivalitetin politik?!

Kryesuesi tha se kjo nuk ka të bëjë me çështje politike. Është marrë qëndrim që të veprohet në këtë mënyrë, andaj për informata më të hollësishme lidhur me këtë çështje mund t'i shtroni pyetje Drejtorisë në mbledhje të Kuvendit.

Shefqet Sylejmani, lidhur me rrënimet tha se këtu është duke u rrënuar diç për të mirë dhe nuk guxojmë që t'ia lejojmë vetes të bindemi nga propaganda të ndryshme. Ai sugjeroi që organet kompetente komunale të kenë kujdes gjatë dhënies së afatit dhjetëvjeçar të shfrytëzimit të pronës komunale, ngase ai mund të tejkalohet. Kërkoj që t'i bëhet trysni Komisionit komunal për ndarjen e pasurisë – banesave që i takojnë komunës dhe pjesës tjetër që i takon koncesionarit në kompleksin banesor “Dielli”, të punojë, pasi që ka shumë keqpërdorime dhe nuk ka kurrfarë shërbime. Është mirë që të hapet pusi i ujit dhe të rregullohet terreni sportiv në këtë kompleks.

Njëherësh kërkoj që të bëhet vizatimi i vijave të bardha në dy korsitë, lartë dhe poshtë, te “Xhamia e Llapit” në mënyrë më kualitative, pasi që shpejt po fshihen.

Lidhur me semaforët inteligjentë, ai gjithashtu pyeti se a paguhet Komisioni mbikëqyrës nga ana e investitorit, si dhe a është e vërtetë që kompania ka lënë mundësi që të komandojë këta semaforë nga zyra dhe se a do të vazhdohet me vënien e tyre edhe në dy – tre vende, duke propozuar që kjo të bëhet.

Milazim Vitia tha se janë djegur 20 ha mal, pronë komunale, në mes të fshatrave Slivovë - Mramor dhe pyeti se nën menaxhimin e kujt është Njësia e zjarrfikësve. Ai gjithashtu kërkoj që rruga e vjetër që qon për në Shkup, të jetë e kalueshme.

Kryesuesi dhe Agim Salihu u përgjigjën në pyetjet e parashtruara dhe paraqitën disa sqarime shtesë.

Shemi Veseli përkrahu mendimin e Shefqet Sylejmanit dhe Aziz Pacollit, duke thënë se do të na bënte nder që një banesë t'i ndahet z. Adem Demaçi. Po ashtu kërkoj që bashkëshortes së Ukshin Hotit t'i lëshohet vendimi për shfrytëzimin e banesës, dhe t'i ndahet një banesë edhe Rrustem Berishës. Kërkoj që të merret vendim për rritjen e numrit të nxënësve nëpër klasa, me theks të veçantë për gjimnazin “Sami Frashëri”, pasi që shumë nxënës me sukses të shkëlqyeshëm kanë mbetur pa u regjistruar. Pagesa e komisioneve të ndryshme të bëhet sipas Ligjit të pagave, në mënyrë që të paguhet vetëkontributet.

Kryesuesi paraqiti sqarime lidhur me kërkesën për marrjen e vendimit për rritjen e numrit të nxënësve nëpër klasa në gjimnazin “Sami Frashëri”.

Mbledhja mbaroi në orën 17:20.

Procesmbajtëse
Alije Gusia , jurise e dipl.

Kryesuesi
Sami Hamiti , ecc. i dipl.

Faqe 6 nga 6
